



Thaçi: S'ka Republika Serbska në Kosovë

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se nuk do të lejohet një Republika Serbska në Kosovë. Ai ka thënë se Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe faktor paqeje në Ballkan. Kurse kryeministri i Serbisë, Ivo Dačić ka thënë se ata janë të gatshëm për të vazhduar procesin e dialogut, por nuk do t'i nënshtrohen procesit » 02



Arsimimi gjerman, perspektiv për Kosovën

Gjimnazi klasik gjerman i Prizrenit, që po jep një frymë shtesë gjermane për zhvillimin dhe të ardhmen më të mirë të Kosovës, është edhe një kontribut tjetër i shoqërisë gjermane dhe i Gjermanisë për zhvillimin kulturor-arsimor të brezit të ri jo vetëm të trekëndëshit Prizren-Kukës-Tetovë, por edhe më gjerë, në hapësirën shqiptare të kësaj ane dhe të krejt Kosovës e rajonit më të gjerë. » 12

Mbledhja e Këshillit të Sigurimit për Kosovën

MIQTË VLERËSOJNË, KUNDËRSHTARËT AKUZOJNË



Përderisa SHBA-të, Franca, Britania e Madhe, gjatë raportimit të djeshëm në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së kanë vlerësuar përparimet që po bëhen në Kosovë, nga ana tjetër Rusia dhe Kina nuk kanë kursyer akuzat ndaj institucioneve të Kosovës, të cilat, sipas tyre, nuk po bëjnë asgjë për sigurinë e serbëve. Madje përfaqësuesi i Rusisë ka kërkuar që në Kosovë për çdo ndryshim të mundshëm, fjalën e fundit duhet ta japë Këshilli i Sigurimit

Humbi një shans

Pas rënies së komunizmit në Evropën Lindore ishte një shans i mirë që të reformohej edhe Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ky mekanizëm sigurie, ku vendimet merren me konensus edhe në kohën e luftës së ftohtë, por edhe pas ndryshimeve që ndodhën në fillim të viteve 90-ta, vazhdoi me formën e vjetër, ku në emër të së drejtës ndërkombëtare për mosndërrhyrje në punët e brendshme të shteteve, mbroheshin interesa të caktuara të Rusisë në mënyrë të veçantë

editorial ...

02

A do të jetë e treta e vërteta për Drenicën?



sport ...

17

Në përkujtim të një të diele tragjike të pranverës së hidhur



Kulturë ...

14

EULEX-i, peng i politikës

05 politikë...

Nuk dorëzohen para 'hajnisë në KEK'

04 aktuale...

Shkëlzen Lluka, drejtor i AKP-së

06 aktuale...



KOMPANIA E SIGURIMEVE / INSURANCE COMPANY
Rr. Sylejman Vokshi Nr. 4, 10 000, Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 244 080; Fax: +386 (43) 244 081
Email: info@dardaniainsurance.com
WEB: www.dardaniainsurance.com

ALG NË PRIZREN

Arsimimi gjerman per

Gjimnazi klasik gjerman i Prizrenit, që po jep një frymë shtesë gjermane për zhvillimin dhe të ardhmen më të mirë të Kosovës, është edhe një kontribut tjetër i shoqërisë gjermane dhe i Gjermanisë për zhvillimin kulturor-arsimorë të brezit të ri jo vetëm të trekëndëshit Prizren- Kukës -Tetovë, por edhe më gjerë, në hapësirën shqiptare të kësaj ane dhe të krejtë Kosovës e rajonit më të gjerë



Bedri Sadiku

Idea për themelimin dhe hapjen e nje gjimnazi klasik gjerman në Prizren lindi në maj të 2003-tës dhe krejte projekti, me nisjen e procesit mesimor, u rrumbullakësua në shtator të 2005-tës, kur ishin rekrutuar dhe perzgjedhur si nxënësit ashtu dhe kuadri mësi-

mor, bashkë me krejtë stafin përcjellës për mbarëvajtje të procesit mësimor. Drejtori e nismëtar dhe udhëheqësi i këtij projekti, z. Valter Hapel, thotë fjalë miradie për punën që e bëjnë në këtë institucion privat arsimor jo vetëm mësimdhënësit e përzgjedhur

në intervista paraprake me ta, por edhe krejtë të punësuarit e tjerë të pakët në administratë dhe ekipi tjetër që nga kuzhinierët e ndihmësit e tyre e deri te rojtarët e ditës dhe natës, që mbikqyrin sigurinë e nxënësve në objektet e vendosura brenda një hapësire prej

katër hektarësh, ku janë lokalet e shkollës për mësimnxënie, dy konviktet, njëri i femrave, që shndëriste nga pastërtia dhe tjetri i meshkujve, Menza me kuzhinë e restorantin e saj ,salla e sporteve dhe tri fusha të sporteve të vogla e një park i gjerë përplot lule të ndryshme si dhe një park botanike, bile dhe me emrat e shënuar të bimëve dhe luleve të mbjella, ndërsa në shkollë krahas mësojtoveve i kishin edhe tre laboratore për lëndët e biologjisë, fizikës e kimisë, të pajisura mjaftë mirë me mjetet përcjellëse dhe elementët e tjerë të domosdoshëm për demonstrim e mbarëvajtje të procesit mësimor. Menaxhimi i mire, puna, përkushtimi i arsimtarëve e profesorëve të tjerë, bashkë me kujdestarët dhe edukatorët e mirëfilltë, që i dijnë jo vetëm obligimet e tyre, që të kujdesen për zhvillimin sa më të mirë edukativo-arsimor të këtij brezi të të rinjëve,

që janë e ardhmja e vendit, por në radhë të parë disiplina dhe përkujdesja për ambientin ku jetojnë e mësojnë, ishin parakushtet themelore mbi të cilat bazohet dhe sukcesi i këtyre nxënësve, që janë daluar me rezultatet e tyre, sidomos në dhënien e provimeve të Maturës Shtetërore, por dhe të Maturës së brendshme, ku notohen në Gjuhë Gjermane, Gjuhë Latine dhe Matematikë, e që është sidomos e vlefshme për ata që do të studiojnë në Gjermani, Zvicër e Austri. Për tu regjistruar në këtë gjimnaz klasik gjerman, nxënësit me sukses më të mirë përzgjidhen përmes një testimi dhe prindërit e tyre, që kanë pastaj dhe një Këshill të prindërve, duhet të paguajnë dhe tarifën e përcaktuar, që për shkollimin vjetor të një nxënësi kapin shumën prej 960 Euro apo 12 muaj nga 80 Euro, ndërsa për vendosjen e një nxënësi a nxë-



spektiv për Kosovën

nëse në konvikt kapë shumë prej 2.040 Euro, apo 170 Euro në muaj, që përfshijnë vendosjen me fjetje e përkujdsje në konvikt dhe ushqimin në Menzën e shkollës me kuzhinë të pajisur shumë mirë, kuzhinierë të shkëlqyer të kësaj ane dhe një restorant mjaft bashkëkohor.

Shkolla, si projekt, me mjetet që siguron nga tarifat e regjistrimit të nxënësve siguron vetëm rreth 60 për qind të buxhetit të saj për veprim, por ndihmohet nga Shoqata e Mbështetësve të saj, ku bëjnë pjesë edhe mësimdhënësit e shumë personalitete të tjera të përfshira në këtë projekt që nga nisma, ndërsa shpenzimet e tjera mbulohe nga donatorët e shumtë ndër të cilët duhet përmendur edhe misionet e karahinave ujezuite të Gjermanisë dhe Austrisë, -ka thënë ndër të tjera Drejtori i Gjymnazit Klasik Gjerman në Prizren, z. Happel, i cili përmendë edhe shumë vizita që i bëhen kësaj shkolle nga më shumë vizitorë jo vetëm gjermanë, por këtu e mbajnë mend shumë mirë edhe një vizitë që e kishte bërë Kancelarja e Gjermanisë, zonja Merkel. Nxënësit, që natyrisht se mësojnë me planprogram të përcaktuar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës, varësisht edhe nga arsimtarët, mundë të shfrytëzojnë dhe shfrytëzojnë edhe tekste mësimore plotësuese, si ishte rasti i tekstit të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe për klasën e shtatë – një botim i Tiranës. Drejtuesit e këtij institucioni privat arsimor thonë se janë mjaftë problematike tekstet e Eduktës Qytetare, por edhe në këtë fushë edukatorët dhe ligjëruesit e kësaj lënde japin krejtë përvojën e tyre më të mirë për një edukim sa më të denjë të këtyre brezave të rinjë, që nesër do të jenë e ardhmja dhe perspektiva zhvillimore e vendit. Për nxënësit shkolla ka të organizuar edhe transportin nga pika të



caktuara të Prizrenit me rrethinë, që i sjellin në mëngjes dhe i kthejnë nxënësit nëpër shtëpitë e veta, kur përfundon procesi mësimor. “Ajo çfarë në vitin 2005 dukej si të ishte një aventurë, me kalimin e viteve u bë histori e sukseseve me një perspektivë të mirë

për të ardhmen e nxënësve tanë dhe me shpresë për Kosovën”, ka thënë në fjalën e tij të rastit në “Vjetarin 2012/13” të Gjymnazit klasik gjerman të njohur më shumë me emrin e tij zyrtar “Asociation ‘Loyola-Gymnasium’”, ambiente të cilat janë vetëm pak

kilometra në dalje të Prizrenit, udhës për tu ngjitur në Rrugën e Kombit, kur shkon për Prishtinë apo Kukës. Në largim e sipër pasi, të shoqëruar nga Drejtori Happel, që ende nuk komunikonte mirë shqip – tha për shkak të moshës, përtacisë, por edhe

se vendësit më shumë i drejttoheshin në gjermanisht e në anglisht - dhe zëvendësi i tij Mark Gojani, professor i anglishtes, që na ndihmoi dhe në rolin e përkthyesit, vizitua gati krejtë ambientet, më shumë mësimdhënëses, ndër ta z. Ramadan H. Ramadanin e Latinishtes, z. Xhafer Beqirajn e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare, i cili gjatë orës mësimore kur i vizitua nxënësve të tij u mbante leksione për Ismail Kadarenë, z. Faton Sh. Kabashin e Matematikës, dhe më shumë nxënës, Drejtorit e stafit të tij dhe posacërisht nxënësve ju uruam punë të mbarë e suksese të reja, sidomos maturantëve, të cilët i presin krahas provimeve lëndore edhe dy maturat – Shtetërorja, që do t’ju vlenë brenda Kosovës dhe ajo e brendshme, e vlefshme për studimet jashtë vendit, veçmas në Gjermani dhe në vendet gjermanofolëse.

